

VENDIM
Nr. 42, datë 30.8.2019

PËR DËNIMIN ADMINISTRATIV TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
DIVJAKË SHA

Në mbështetje të pikës 1/h, të nenit 23, dhe pikës 1/ç, të nenit 32/1 të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 30.8.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Miratimi i projektvendimit ‘Për dënimin administrativ të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë sh.a.’”,

konstatoi:

Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 32, datë 10.7.2019, “Për fillimin e procedurës për dënimin administrativ të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë sh.a.” (vendimi i KKRR-së nr. 32) filloi procedurën për marrjen e masës administrative “Gjobë në masën 300 000 lekë” ndaj shoqërisë UK Divjakë, për shkeljen administrative “Ushtrimi i veprimtarisë pa licencë”.

Në zbatim të procedurës administrative të parashikuar në pikën 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 23, të ligjit nr. 8102, vendimi i KKRR-së nr. 32, iu njoftua shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë sh.a, me shkresën nr. 276 prot, datë 24.7.2019.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë sh.a. nuk e ankimoi, vendimin e KKRR-së nr. 32, brenda afatit ligjor.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë sh.a. dënohet me gjobë, në shumën 300 000 lekë, për kundërvajtjen administrative “Ushtrimi i veprimtarisë pa licencë”.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit të njoftojë Shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Gjykatës Administrative Tiranë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni mbi vendimin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani